



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:294763

Datë: 05.10.2021

Numri i dokumentit: 02246345

**PA1.nr.974/2021**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K., nga ....., Komuna e Skenderajt, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.95/20, të datës 18.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04.10.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.95/20, të datës 18.06.2021, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.95/20, të datës 18.06.2021, është liruar nga akuza i akuzuari F.K., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par. 2 të KPK, për shkak se nuk është provuar se i njëjti e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Në kuptim të nenit 115 par. 2 dhe 282 par. 1 dhe 2 pika 2.5 të KPPK, gjykata e shkallës së parë ka urdhëruar konfiskimin në mënyrë të përhershme automjetin e markës “Volkswagen”, tipi “Golf 2 (19 E)”, ngjyrë e gjelbër, viti i prodhimit 1990, me targa “0.....”, nr. numër të shasisë W....., po ashtu në mënyrë të përhershme konfiskohen edhe çelësat e këtij automjeti si dhe Certifikata e regjistrimit të automjetit “C.....”.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, Agjensioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, është obliguar që të ndërmarr veprimet përkatëse ligjore me sendet e konfiskuara si në pikën e lartcekur.

Shpenzimet e procedurës penale kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Pala e dëmtuar, F.Th., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar ën kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.991/2021, të datës 30.07.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

#### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret gabimisht e ka liruar nga akuza të akuzuarin për veprën penal e cila i vihet në barrë. Gjatë shqyrtimit kryesor dëshmitarët e dëgjuar, si dhe provat materiale si dhe deklaratat e dëshmitarit, vërtetojnë që i akuzuari ka kryer disa riparime në automjet. Gjatë ekspertizës, e më vonë me super ekspertizë, është vërtetuar që në automjet kishte qenë si shtesë e salduar kiti dhe numri i shasisë. I dëmtuari F.Th., ka deklaruar që automjetin e ka blerë nga i akuzuari, e dëshmitari B. K., ka theksuar që automjetin ia kishte shitur të akuzuarit dhe i njëjti ka qenë në gjendje të rregullt. Gjatë gjykimit, duke konsideruar që nuk kishte pasur marrëveshje, nuk mund të vërtetohet se në çfarë gjendje ka qenë automjeti kur i akuzuari ia ka shitur të njëjtin të dëmtuarit. Gjykata nuk e ka vlerësuar faktin se B.K. automjetin e ka blerë në vitin 2003, dhe e ka drejtuar deri në vitin 2012 kur edhe ia ka shitur të akuzuarit. Gjatë kësaj periudhe dëshmitari nuk ka pasur asnjë problem me regjistrimin e automjetit. Nga momenti i shitjes së të akuzuarit e deri në vitin 2019 kur i akuzuari ia ka shitur të dëmtuarit F., dhe kur ai ka dashur që ta regjistroj atë përmes E... ka vërejtur që në automjet është punuar diçka mbi shasi. Është e pa qartë se si gjykata e shkallës së parë e ka liruar nga akuza të akuzuarin, kur janë faktet e dukshme që janë bërë riparime dhe punime në numrin e shasisë në momentin kur automjeti ka qenë në posedim të akuzuari dhe kur ai ka qenë pronar. Edhe vet i akuzuari ka deklaruar se e ka ngjyrosur automjetin, që ka ndryshuar edhe diçka në të, gjë që tregon faktin që me rastin e këtyre punimeve ka ardhur deri te instalimi i numrit të shasisë si dhe saldimit në automjet tjetër. Gjykata është dashur që ta ketë parasysh se automjeti të

cilin dëshmitari B.K. ia ka shitur të akuzuarit ka qenë me benzinë kurse më vonë e ka ndërruar dhe ka përdorur me plin. Të gjitha këto rrethana vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par. 2 të KPK, andaj konsiderojmë që gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të drejtë e ka liruar nga akuza të akuzuarin dhe po që se do të kishte pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit konkret të akuzuarin do ta shpallte fajtor dhe do ti shqiptonte dënimin sipas ligjit.

Kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykim i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal si dhe se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila rezulton nga provat e administruara në shkresat e lëndës, si ato personale ashtu edhe ato materiale. Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe deri në fjalën përfundimtare vërtetoi se nuk ishte kontestues fakti se automjeti i markës Volkswagen Golf II (19E), me vit të prodhimit 1990, ngjyrë e gjelbër, me targa të regjistrimit “0.....”, dhe numër të shasisë “W....”, i akuzuari fillimisht e kishte blerë nga Bashkim Keqa në vitin 2012, ndërsa të njëjtin ia kishte shitur të dëmtuarit F.Th. në vitin 2017. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se nuk ishte kontestues fakti se numri i shasisë së automjetit në fjalë në pjesën e përparme ishte i inkorporuar gjegjësisht i salduar, i ngjyrosur dhe se nuk ishte sipas standardit Euvid, po ashtu i njëjti numër i shasisë nuk ishte i vendosur në zonat tjera përkatëse. Kontestuese për gjykatën e shkallës së parë në këtë çështje penale ishte fakti nëse i akuzuari në këtë automjet kishte ndërhyrë në numrin e shasisë së tij duke e inkorporuar, salduar dhe ngjyrosur të njëjtin apo se këtë e kishte bërë ndonjë person tjetër. Këtë gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit F.Th. dhe dëshmitarit B.K., përmes të cilave vërtetoi faktin se, automjeti në fjalë i akuzuari e kishte blerë nga dëshmitari B.K., ndërsa të njëjtin ia kishte shitur të dëmtuarit F.Th..., ndërsa meqenëse motori në këtë automjet ishte dizel, kurse në librezën e tij figuronte benzinë, i dëmtuari kishte shkuar të kryente homologimin në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve “E...” në Fushë Kosovë, me qëllim të legalizimit, mirëpo qendra ia kishte refuzuar këtë me arsyetimin se automjeti dyshohet se ishte i prekur. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë, i ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit, të cilët kanë theksuar se nuk e kontestojnë ekspertizën e forenzikës dhe të makinerisë, në të cilën theksohet se në automjet ka pasur ndërhyrje, mirëpo me asnjë provë materiale nuk është provuar se subjekti i kryerjes së veprës penale është këtu i akuzuari F.K.. Të njëjtën gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga ekspertiza e makinerisë me shkrim punuar nga inxh. S.B..., më dt. 07.04.2021, nga raporti fillestar i incidentit nr.2011-BF-0729 i dt. 03.11.2011, përpiluar nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Jugu në Mitrovicë, së bashku me raportin e policit hetues nr. 2019-BI-84 të dt. 19.06.2019, dhe vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nr. 2019-BI-84, njoftimi me shkrim për refuzim në procedurë të ndërrimit të motorit lëshuar nga QAK E... në Fushë Kosovë, të dt. 18.06.2019, së bashku me foto albumin e bashkangjitur si dhe certifikata e regjistrimit të automjetit nr.”C....”, raporti i ekspertimit punuar nga Agjencia e Kosovë për Forenzikë nr. ref. AKF/2019-1833 / 2019-1627 i dt. 06.08.2019, konfirmimet e sigurimit të dt. 25.01.2021 lëshuar nga kompania e sigurimeve “E....”, për periudhën kohore 20.09.2005 – 20.09.2006, 20.09.2006 – 20.09.2007, 31.12.2007 – 03.12.2008, 22.12.2008 – 22.12.2009, 28.12.2009 – 28.12.2010, 27.12.2010 – 27.12.2011, 21.11.2012 – 21.11.2013, 18.12.2013-18.12.2014, 15.01.2015 – 15.01.2016, 12.02.2016 – 12.02.2017, 14.05.2018 – 14.05.2019, nga dëshmia e të dëmtuarit F.Th., dhe e dëshmitarit B.K., nga raporti për ekspertimin punuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë nr. ref. AKF/2019-1833 / 2019-1627, të dt. 06.08.2019 dhe Ekspertizës së makinerisë të dt. 07.04.2021 punuar me shkrim nga eksperti inxh. S.B... Andaj, duke u bazuar në të gjitha ato që u theksuan më lartë, konsiderojmë se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.974/2021, të datës 04.10.2021**

**Sekretarja juridike,**  
**Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Zyhdi Haziri**